

**URDHËR**  
**Nr. 170, datë 13.12.2023**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT  
SIGURIE PËR MONITORIMIN QË ZBATOHET NGA SIPËRMARRJET  
HEKURUDHORE, ADMINISTRATORËT E INFRASTRUKTURËS DHE NGA  
SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR MIRËMBAJTJEN, PAS MARRJES SË  
CERTIFIKATËS SË VETME TË SIGURISË OSE AUTORIZIMIT TË SIGURISË”**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2 dhe shkronjës “c”, të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullore “Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**

**RREGULLORE**

**MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT SIGURIE, PËR MONITORIMIN QË  
ZBATOHET NGA SIPËRMARRJET HEKURUDHORE, ADMINISTRATORËT E  
INFRASTRUKTURËS DHE NGA SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR MIRËMBAJTJEN,  
PAS MARRJES SË CERTIFIKATËS SË VETME TË SIGURISË OSE AUTORIZIMIT TË  
SIGURISË<sup>1</sup>**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është vendosja e një metode të përbashkët sigurie për monitorimin, duke mundësuar menaxhimin efektiv të sigurisë në sistemin hekurudhor gjatë aktiviteteve të funksionimit dhe mirëmbajtjes së tij dhe, sipas rastit, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

---

<sup>1</sup> Kjo rregullore përafrohet plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1078/2012, e datës 16 nëntor 2012 “Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që do të zbatohet nga ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës pas marrjes së një certifikate sigurie ose autorizimi sigurie dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen”, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 32012R1078, seria L 320/8, datë 17.11.2012.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja e sigurisë në transportin hekurudhor dhe përmirësimi i mirëmbajtjes nëpërmjet:

a) kontrollit për zbatimin e saktë dhe efektivitetin e të gjitha proceseve dhe procedurave në sistemin e menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut. Në rastin e sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës, kontrolli përfshin elementet teknike, operacionale dhe organizative që janë të nevojshme për lëshimin e certifikimit/autorizimit të specifikuar në nenet 65 dhe 66, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”;

b) kontrollin për zbatimin e saktë të sistemit të menaxhimit në tërësi, dhe nëse sistemi i menaxhimit arrin rezultatet e pritura; dhe

c) identifikimin dhe zbatimin e masave të duhura parandaluese, korrigjuese ose të dyja llojet e masave nëse zbulohet ndonjë rast përkatës i mospërputhjes me pikat “a” dhe “b”.

### Neni 3

#### **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet në transportin hekurudhor shqiptar për sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas marrjes së certifikatës së sigurisë ose autorizimit të sigurisë.

### Neni 4

#### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e nenit 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Përveç tyre, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “sistemi i menaxhimit të sigurisë” nënkupton ose janë sistemet e menaxhimit të sigurisë të sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës, për të siguruar menaxhimin e sigurt të operacioneve të saj dhe që është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 64, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ose sistemi i mirëmbajtjes së subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 137 të këtij ligji;

b) “monitorim” nënkupton marrëveshjet e vendosura nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës ose subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen për të kontrolluar zbatimin e saktë dhe efektiv të sistemit të tyre të menaxhimit;

c) “ndërveprim” nënkupton të gjitha pikat e ndërveprimit gjatë kohës së funksionimit të një sistemi ose nënsistemi, duke përfshirë funksionimin dhe mirëmbajtjen ku aktorë të ndryshëm të sektorit hekurudhor punojnë së bashku për të menaxhuar rreziqet.

### Neni 5

#### **Procesi i monitorimit**

1. Çdo sipërmarrje hekurudhore, administrator infrastrukture dhe subjekt përgjegjës për mirëmbajtjen është përgjegjës për kryerjen e procesit të monitorimit, sipas përcaktimeve në aneksin bashkëlidhur.

Ky proces siguron që masat e kontrollit të rrezikut, të zbatuara nga kontraktorët e tyre, të monitorohen gjithashtu në përputhje me këtë rregullore. Për këtë qëllim, ata zbatojnë procesin e monitorimit të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur, ose do të kërkojnë nga kontraktorët e tyre që ta zbatojnë këtë proces nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale.

2. Procesi i monitorimit përmban aktivitetet e mëposhtme:

a) përcaktimin e strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) për monitorim;

b) mbledhjen dhe analizën e informacionit;

- c) hartimin e një plani veprimi për rastet e mospërputhjes së papranueshme me kërkesat e përcaktuara në sistemin e menaxhimit;
- ç) zbatimin e planit të veprimit, nëse hartohet një plan i tillë;
- d) vlerësimin e efektivitetit të masave të planit të veprimit, nëse hartohet një plan i tillë.

#### Neni 6

### **Shkëmbimi i informacionit ndërmjet aktorëve të përfshirë**

1. Sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, duke përfshirë kontraktorët e tyre, duhet të sigurojnë, nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale, që çdo informacion përkatës, lidhur me sigurinë që rezulton nga zbatimi i procesit të monitorimit të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur, të shkëmbehet ndërmjet tyre, për të mundësuar palën tjetër të ndërmarrë çdo veprim korrigjues, të nevojshëm për të siguruar arritjen e vazhdueshme të performancës së sigurisë së sistemit hekurudhor.

2. Nëse, nëpërmjet aplikimit të procesit të monitorimit, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen identifikojnë çdo rrezik të rëndësishëm sigurie, në lidhje me defektet dhe mospërputhjet e ndërtimit ose keqfunksionimet e pajisjeve teknike, përfshirë ato të nënsistemeve strukturore, ata ia raportojnë këto rreziqe palëve të tjera të përfshira, për t'iu mundësuar atyre të ndërmarrin veprimet e nevojshme korrigjuese, për të siguruar arritjen e vazhdueshme të performancës së sigurisë së sistemit hekurudhor.

#### Neni 7

### **Raportimi**

1. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës i raportojnë Autoritetit Kombëtar të Sigurisë, në vijim Autoriteti, për zbatimin e kësaj rregulloreje, nëpërmjet raporteve të tyre vjetore të sigurisë, në përputhje me nenin 64, pika 7, ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

2. Autoriteti raporton te Agjencia Evropiane e Hekurudhave, në vijim Agjencia, për zbatimin e kësaj rregulloreje nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe për aq sa ka dijeni, nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen në përputhje me nenin 72 të ligjit më sipër.

3. Raporti vjetor i mirëmbajtjes së subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave i cili, vihet gjithashtu në dispozicion me kërkesë të Autoritetit, përfshin të gjitha informacionet/të dhënat përkatëse të nevojshme dhe informacion për përvojën e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtje në zbatimin e kësaj rregulloreje. Agjencia e mbledh këtë informacion në koordinim me organet përkatëse të certifikimit.

4. Subjektet e tjera përgjegjëse për mirëmbajtjen, që nuk përfshihen në detyrimin e pajisjes me certifikatë për mirëmbajtjen, ndajnë gjithashtu përvojën e tyre me Agjencinë për zbatimin e kësaj rregulloreje. Agjencia koordinon shkëmbimin e përvojës me këto subjekte përgjegjëse për mirëmbajtjen.

5. Autoriteti mbështet Agjencinë në mbledhjen e këtij informacioni nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës.

#### ANEKS

### **Procesi i monitorimit**

#### **1. Të përgjithshme**

1.1 Dokumentet në procesin e monitorimit do të jenë të gjitha proceset dhe procedurat e përfshira në sistemin e menaxhimit, duke përfshirë masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut.

1.2 Aktivitetet e përmendura në nenin 5, pika 2 e rregullores së procesit të monitorimit përshkruhen në seksionet 2 deri në 6.

1.3 Ky proces monitorimi përsëritet vazhdimisht, siç tregohet në diagramin më poshtë në shtojcë.

## **2. Përcaktimi i strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) për monitorim**

2.1 Bazuar në sistemin e tyre të menaxhimit, çdo sipërmarrje hekurudhore, administrator infrastrukture dhe ent përgjegjës për mirëmbajtjen është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) të monitorimit.

2.2 Vendimi për atë që duhet dhënë përparësi do të marrë parasysh informacionin nga fushat që sjellin rreziqet më të mëdha dhe, nëse nuk monitorohen në mënyrë efektive, mund të çojnë në pasoja negative për sigurinë. Vendoset një renditje prioriteti për aktivitetet e monitorimit dhe tregohet koha, munda dhe burimet e nevojshme. Përcaktimi i prioriteteve merr parasysh edhe rezultatet nga aplikimet e mëparshme të procesit të monitorimit.

2.3 Procesi i monitorimit identifikon, sa më herët që të jetë e mundur, raste të mospërputhjes në aplikimin e sistemit të menaxhimit që mund të rezultojë në aksidente, incidente, për pak humbje ose dukuri të tjera të rrezikshme. Ajo çon në zbatimin e masave për të korrigjuar rastet e tilla të mospërputhjes.

2.4 Strategjia dhe plani(et) e monitorimit përcaktojnë ose tregues sasiorë ose cilësorë, ose një përzjerje të të dyjave që mund të:

a) japin paralajmërime të hershme për çdo devijim nga rezultati i pritur, ose siguri se rezultati i pritshëm është arritur siç është planifikuar;

b) japin informacion për rezultatet e padëshiruara;

c) mbështesin vendimmarrjen.

## **3. Mbledhja dhe analiza e informacionit**

3.1 Mbledhja dhe analiza e informacionit kryhet sipas strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) të përcaktuara për monitorimin.

3.2 Për çdo tregues të përcaktuar të përmendur në pikën 2.4, duhet të kryhen sa më poshtë:

a) një koleksion informacioni të nevojshëm;

b) një vlerësim nëse proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut janë zbatuar në mënyrë korrekte;

c) një kontroll nëse proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut janë efektive dhe nëse ato arrijnë rezultatet e pritura;

ç) një vlerësim nëse sistemi i menaxhimit në tërësi zbatohet saktë dhe nëse ai arrin rezultatet e pritura;

d) një analizë dhe vlerësim të rasteve të mospërputhjes së identifikuar me pikat “b”, “c” dhe “ç”, si dhe identifikimin e shkaqeve të tyre.

## **4. Hartimi i një plani veprimi**

4.1 Për rastet e identifikuara të mospërputhjes, që konsiderohen të papranueshme, hartohet një plan veprimi. Kjo do të:

a) çojë në zbatimin e proceseve, procedurave, masave teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut, të zbatuara në mënyrë korrekte siç specifikohet; ose

b) përmirësojë proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut ekzistues; ose

c) identifikojnë dhe zbatojnë masa shtesë të kontrollit të rrezikut.

4.2 Plani i veprimit duhet të përfshijë në veçanti informacionin e mëposhtëm:

a) objektivat dhe rezultatet e pritura;

b) korrigjuese, parandaluese ose të dyja llojet e masave të nevojshme;

c) personi përgjegjës për zbatimin e veprimeve;

ç) datat deri në të cilat veprimet do të zbatohen;

d) personi përgjegjës për vlerësimin e efektivitetit të masave të planit të veprimit, në përputhje me nenin 6;

dh) një rishikim i ndikimit të planit të veprimit në strategjinë e monitorimit, prioritetet dhe planin(et).

4.3 Për menaxhimin e sigurisë në ndërveprimet, sipërmarrja hekurudhore, administratori i infrastrukturës ose subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen vendosë, në marrëveshje me aktorët e

tjerë të përfshirë, se kush do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit të kërkuar ose pjesëve të tij.

#### **5. Zbatimi i planit të veprimit**

5.1 Plani i veprimit, i përcaktuar në seksionin 4, zbatohet në mënyrë që të korrigjohen rastet e identifikuara të mospërputhjes.

#### **6. Vlerësimi i efektivitetit të masave të planit të veprimit**

6.1 Zbatimi korrekt, përshtatshmëria dhe efektiviteti i masave të identifikuara në planin e veprimit do të kontrollohen duke përdorur të njëjtin proces monitorimi, siç përshkruhet në këtë shtojcë.

6.2 Vlerësimi i efektivitetit të planit të veprimit përfshin në veçanti veprimet e mëposhtme:

- a) verifikimi nëse plani i veprimit është zbatuar dhe plotësuar në mënyrë korrekte sipas planit;
- b) verifikimi nëse është arritur rezultati i pritur;
- c) verifikimin nëse ndërkohë kanë ndryshuar kushtet fillestare dhe nëse masat e kontrollit të rrezikut, të përcaktuara në planin e veprimit, janë ende të përshtatshme për rrethanat e dhëna;
- ç) verifikimi nëse masa të tjera të kontrollit të rrezikut janë të nevojshme.

#### **7. Dëshmi nga aplikimi i procesit të monitorimit**

7.1 Procesi i monitorimit dokumentohet për të vërtetuar se është zbatuar saktë. Ky dokumentacion vihet në dispozicion kryesisht për qëllime të vlerësimit të brendshëm. Sipas kërkesës:

- a) sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të autoritetit;
- b) subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të organit certifikues. Nëse ndërveprimet menaxhohen nëpërmjet kontratave, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës.

7.2 Dokumentacioni i prodhuar, sipas pikës 7.1, përfshin në veçanti:

- a) një përshkrim të organizatës dhe personelit të caktuar për të kryer procesin e monitorimit;
- b) rezultatet e aktiviteteve të ndryshme të procesit të monitorimit, të listuara në nenin 3(2) dhe në veçanti vendimet e marra;
- c) në rastin e rasteve të mospërputhshmërisë së identifikuar, që konsiderohen të papranueshme, një listë e të gjitha masave të nevojshme që duhen zbatuar për të arritur rezultatin e kërkuar.

### **SHTOJCA**

#### **Kuadri për procesin e monitorimit**

